



**GLOBAL
INITIATIVE**

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

SË BASHKU JEMI MË TË FORTË

Forcimi i qëndresës së shoqërisë
civile në vendet e Ballkanit Perëndimor

Kristina Amerhauser | Walter Kemp

SHKURT 2021

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Ky raport u hartua nga Observatori mbi Ekonomitë e Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs), një organizatë anëtare e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), dhe Fondit të Qëndresës së GI-TOC.

Ky raport bazohet mbi të dhëna, informacione dhe analiza që janë mbledhur dhe shkëmbyer nga aktivistë të shoqërisë civile që punojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kryesisht nga Anesa Agović, Aurora Birbilaj, Sasha Xhorxheviç, Vesna Poposka, dhe Erjona Popova. I falënderojmë për kontributin e vyer dhe angazhimin e sinqertë dhe konstruktiv përgjatë gjithë procesit të studimit. Falenderime të veçanta shkojnë gjithashtu për Fatjona Mejdinin, Mariana Mora Gomez, dhe Ian Tennant për mbështetjen e tyre.

Ky botim është hartuar me mbështetjen financiare të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë. Vetëm GI-TOC mban përgjegjësi për përmbajtjen e këtij studimi, dhe në të nuk pasqyrohen domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Gjermanisë.

MBI AUTORËT

Kristina Amerhauser punon si analiste, dhe po zhvillon kërkime dhe studime mbi Ballkanin perëndimor, në kuadër të punës me SEE-Obs. Kristina ka një diplomë master për studime ndërkombëtare nga Shkolla për Studime Ndërkombëtare në Vjenë.

Walter Kemp drejton zyrën e studimeve në Iniciativën Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), dhe drejton Observatorin e Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs). Më parë ka mbajtur një sërë postesh të rëndësishme në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ka qenë zëvendës-president i Institutit Ndërkombëtar të Paqes (International Peace Institute), si dhe ka punuar si zëdhënës dhe autor deklaratash e fjalimesh pranë Zyrës mbi Drogën dhe Krimin të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kemp është autor i një sërë punimesh mbi parandalimin e konflikteve, marrëdhëniet midis krimin dhe konflikteve, si dhe mbi çështje që lidhen me sigurinë në Evropë.

© 2021 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë apo material nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në asnjë lloj forme apo mënyre pa miratimin me shkrim nga Iniciativa Globale.

Kopertina: © Klub Masa Mostar

Kopertina është dizenuar nga: Flame Design

Për çdo informacion shtesë ju lutemi kontaktoni në adresën e mëposhtme:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime
Avenue de France 23
Geneva, CH-1202
Switzerland

www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	i
Hyrje	1
Shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor	4
Analizë e zhvillimeve dhe tendencave kriminale në rajon nga këndvështrimi i shoqërisë civile	12
Mbështetje për faktorët që mundësojnë qëndresën shoqërore	17
Konkluzione dhe hapat për të ardhmen	22
Shënime.....	25

PËRMBLEDHJE

Në kushtet aktuale, kur duket se hapësirat për shoqërinë civile po tkurren në Ballkanin perëndimor, pasi OJQ-të janë vazhdimisht nën presionin e qeverive dhe gjithnjë e më të shqetësuara për sigurinë dhe vazhdimësinë e tyre, ky raport bën një analizë të krimit të organizuar dhe korrupsionit në rajon nga këndvështrimi i shoqërisë civile. Ai synon të paraqesë një përmbledhje të përbaljes së organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin perëndimor me krimin e organizuar dhe korrupsionin, dhe vë në pah aktivitetet dhe shqetësimet e tyre kryesore.

TERMA DHE SHKURTIME

OSHC	organizata të shoqërisë civile
GI-TOC	Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar
OJQMQ	Organizata jo-qeveritare të mbështetura nga qeveria
OJQ	Organizata jo-qeveritare
OCCRP	Projekti i Raportimit mbi Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin
WB6	Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor



HYRJE

Më pak se një për qind e rreth 100,000 organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të regjistruara në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6)¹ merren drejtpërdrejt me krimin e organizuar ose korrupsionin. Kjo është pak e çuditshme po të kemi parasysh ndikimin serioz dhe shumë të përhapur të këtyre problemeve në këtë rajon. Sidoqoftë, ky raport tregon se disa OSHC angazhohen seriozisht në analizimin e kërcënimeve që vijnë nga krimi i organizuar dhe korrupsioni, dhe punojnë me çështje që lidhen me përdorimin e drogës, problemet rinore, ri-integrimin në shoqëri pas daljes nga burgu, lirinë e medias, çështje mjedisore, dhe grupet e marginalizuara.

Shumë nga këto OSHC përballen me sfida të ngjashme, duke përfshirë presionin qeveritar, vështirësi në mbledhjen e fondeve për të financuar aktivitetet e tyre, si dhe shqetësime që lidhen me sigurinë. Në fakt duket se hapësirat për shoqërinë civile në rajon po tkurren. Kjo është shqetësuese, pasi OSHC-të në Ballkanin perëndimor luajnë një rol kyç në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe analizmin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe forcimin e rezistencës shoqërore ndaj këtyre problemeve.

Ky raport analizon punën e OSHC-ve në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në vendet e WB6. Ai vë në pah disa nga sfidat dhe problemet e tyre kryesore, përshkruan perceptimet e tyre mbi ndikimin e krimit të organizuar në komunitetet vendase, dhe identifikon praktika të mira pune. Studimi ynë gjithashtu analizon mënyrat se si mund të forcohet qëndresa dhe rezistenca e këtyre organizatave kundër krimit të organizuar, dhe si mund të ndikojnë vetë këto OSHC në forcimin e rezistencës së komuniteteve në zona të caktuara dhe në të gjithë rajonit. Raporti më tej paraqet edhe një tablo të përgjithshme të OSHC-ve që merren në mënyrë aktive me tema të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

▲ Pavarësisht nga probleme që lidhen me fushën e sigurisë, disa organizata të shoqërisë civile në Ballkanin perëndimor përballen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Këtu lart, një aktivitet kundër krimit të organizuar nga OJQ shqiptare Së bashku për jetën.

© Together for Life




FIGURA 1 Ndarja në grupe e personave të intervistuar për këtë studim.

Metodologjia

Për të paraqitur një tablo sa më të plotë, raporti bazohet në punën kërkimore të zhvilluar nga Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC) mbi ekonominë e paligjshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, në nivel lokal dhe rajonal. Në mënyrë që të sigurohet një mbështetje sa më e efektshme për përmirësimin e nivelit të rezistencës dhe qëndrueshmërisë, ky raport përshkruan angazhimin e shoqërisë civile në përballjen me krimin e organizuar dhe korrupsionin në rajon. Të dhënat u mbledhën nga pesë studiues me njohuri të gjera në lidhje me krimin e organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ata kryen më shumë se 110 intervista me përfaqësues të shoqërisë civile (kryesisht intervista individuale), duke përfshirë punonjës të organizatave joqeveritare (OJQ) dhe organeve mediatike, si dhe pjesëtarë të komunitetit, qytetarë dhe përfaqësues të autoriteteve lokale. Shpërndarja në grupe e të anketuarve tregohet në Figurën 1.

Të dhënat cilësore që u mbledhën për këtë raport u shoqëruan me një analizim të legjisllacioneve kombëtare, informacioneve zyrtare dhe raporteve ndërkombëtare mbi shoqërinë civile për secilin nga të gjashtë vendet. Të dhënat e mbledhura u vlerësuan më pas gjatë fazës së takimeve kombëtare mbi qëndrueshmërinë dhe rezistencën (aktivitete me komunitetin) në nëntor 2020, ku morën pjesë më shumë se 100 pjesëmarrës nga i gjithë rajoni. Gjatë këtyre takimeve, pjesëmarrësit diskutuan mbi zhvillimet lokale dhe çështjet aktuale në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin, u identifikuan fusha të përbashkëta të punës dhe u vlerësuan nevojat për forcimin e rezistencës së OSHC-ve që punojnë në Ballkanin Perëndimor.

Një bashkëpunim i ngushtë midis 16 organizatave që përfitojnë mbështetje nga Fondi i Rezistencës së GI-TOC në rajon ka siguruar një tablo më të plotë të punës së OSHC-ve që përballen me krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe sfidave me të cilat përballen. Organizatat që përfitojnë fonde dhanë kontributin e tyre në hartimin e rekomandimeve të këtij raporti, të cilat u diskutuan dhe u finalizuan gjatë dialogut rajonal mbi qëndresën e shoqërive në rajon, në dhjetor 2020.

Rrjeti i qëndresës

Që nga viti 2016, GI-TOC ka dokumentuar dhe analizuar qëndrimet në nivel komuniteti kundrejt krimit të organizuar nëpërmjet një sistemi të ngritur për vlerësimin e rezistencës. Në këtë studim paraprak, niveli i qëndresës nga ana e shoqërisë u konceptua si një proces shumëdimensional në kuadër të analizimit të marrëdhënieve komplekse midis krimit të organizuar dhe zhvillimit të vendit. Gjatë këtij studimi u analizuan kapacitetet dhe mundësitë e komuniteteve për veprime kolektive që zbusin dhe kufizojnë ndikimin e krimit të organizuar dhe qeverisjes së dobët mbi shoqërinë.² Analiza dhe vlerësimi i rezistencës nga ana GI-TOC kalon nëpër tre hapa,³ që aplikohen edhe për studimin aktual, ashtu si tregohet në Figurën 2.




FIGURA 2 Përqasja ndaj qëndresës dhe rezistencës në studimin aktual.

Fondi i rezistencës nisi të funksiononte zyrtarisht në prill 2019, duke ofruar grante për të financuar, forcuar dhe mbështetur nismat lokale në qëndresën ndaj krimit të organizuar. Fondi identifikon dhe mbështet aktivistët kryesorë të shoqërisë civile dhe ndihmon në përmirësimin e aftësive operative, me qëllim krijimin e rrjeteve të rezistencës në komunitetet e prekura nga krimi i organizuar dhe dhuna. Që nga fillimi i punës së tij, Fondi ka siguruar mbështetje për mbi 70 projekte të drejtuara nga më shumë se 60 organizata në 31 vende të ndryshme, ku 16 nga këto organizata e kanë qendrën në vendet e WB6. Më shumë se 1.5 milionë euro janë shpërndarë në grante që nga fillimi i funksionimit të Fondit të Rezistencës.⁴

Ndonëse raporti përqendrohet mbi aktivitetet e OSHC-ve në të gjithë rajonin, është e rëndësishme të kihet parasysh se shoqëria civile nuk është një grup homogjen, që mban të njëjtin qëndrim kundrejt krimit të organizuar apo masave që duhet të merren. Termi 'shoqëri civile' që përdoret në këtë kontekst i referohet individëve dhe organizatave që ndërmarrin veprime kolektive në të mirë të interesit publik, pa qenë pjesë e institucioneve shtetërore. Në të përfshihen grupe qytetarësh, sindikata, akademikë, gazetarë, dhe faktorë të tjerë që kanë një rol thelbësor në drejtimin e shoqërisë.⁵

Baza ligjore në vendet e Ballkanit përfshin terminologji të ndryshme për të përshkruar OSHC-të, duke iu referuar si shoqata, fondacione, dhe OJQ; po kështu dhe në këtë studim përdoren paralelisht termat OSHC dhe OJQ.

Shpresojmë që ky raport të shpalosë punën e aktivistëve të guximshëm dhe të përkushtuar të shoqërisë civile, dhe se duke vënë në pah sfidat me të cilat përballen, do të rritet vëmendja dhe mbështetja për punën e tyre të rëndësishme dhe forcimin e rrjeteve të shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit perëndimor.



▲
Fushatë e organizuar
nga shoqëria civile
në Serbi për të
rritur nivelin e
ndërgjegjësimit mbi
kreditë e paligjshme
me interesa të larta.
© Protecta

SHOQËRIA CIVILE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në zona që vuajnë nga nivele të larta të qeverisjes kriminale, ndodh rëndom që institucionet shtetërore përgjegjëse për qeverisjen dhe sigurinë (në nivel lokal apo kombëtar) nuk janë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre, madje ndonjëherë këto institucione përshkruhen edhe si të “kapura” nga krimi.⁶ Në Ballkanin perëndimor, ekosistemi i krimit përshkruhet si një “marrëdhënie që i ngjason një ndërmarrjeje të përbashkët biznesi midis strukturave shtetërore dhe grupeve kriminale,” ku krimi i organizuar dhe korrupsioni janë të lidhur ngushtë më njëri-tjetrin.⁷

Në këtë kontekst, shoqëria civile dhe aktorët jo-shtetërorë janë bërë protagonistë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe janë bërë pjesë integrale e kundërpërgjigjes ndaj këtyre fenomeneve për shumë vite me radhë. Sidoqoftë, vetëm një numër i vogël i OSHC-ve në rajonin e Ballkanit perëndimor merren me korrupsionin, dhe një numër akoma më i vogël përqendrohet mbi krimin e organizuar. Shumica e organizatave merren me të drejtat e njeriut, demokratizimin, shtetin ligjor, dhe integrimin në Bashkimin Evropian, kulturën dhe artet, zhvillimin dhe edukimin e të rinjve, mbrojtjen e mjedisit dhe reformat ekonomike; dhe në fakt, në të gjithë rajonin e Ballkanit perëndimor është identifikuar vetëm një organizatë që merret ekskluzivisht me krimin e organizuar dhe korrupsionin.⁸

Ballkani Perëndimor është një mjedis i vështirë pune për OSHC-të, veçanërisht duke patur parasysh që hapësira për shoqërinë civile dhe mediat e pavarura në rajon po tkurret. OSHC-të po sulmohen me fushata shpifjesh, presione dhe madje edhe kërcënime nga një sërë faktorësh. Për shembull, në korrik 2020, Administrata për Parandalimin e Pastrimit të Parave në ministrinë e financave të Serbisë publikoi një listë me punonjës të medias dhe OSHC-ve, që do t'u kontrolltoheshin llogaritë bankare për pastrim parash ose lidhje me financimin e terrorizmit.⁹ Në Malin e Zi, parlamenti miratoi një ligj të ri për mediat, që i detyron gazetarët të zbulojnë burimet e tyre me kërkesën e prokurorisë.¹⁰ Në Maqedoninë e Veriut, presioni mbi shoqërinë

civile vazhdon të jetë i fortë, ndonëse qeveria zyrtarisht e ka braktisur fushatën e mëparshme të 'ç-Sorosizimit', kur pretendonte se OSHC-të po përpqeshin të rrëzonin qeverinë.¹¹ Në të gjithë rajonin, duke përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, dhe Bosnjë Hercegovinën, ka patur disa njoftime mbi sulme verbale dhe fizike ndaj gazetarëve, që kanë ardhur duke u shtuar që nga fillimi i pandemisë COVID-19.¹²

Këto zhvillime negative u vunë në pah edhe nga Treguesi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për vitin 2019, që tregoi se nivelet e qëndrueshmërisë të OSHC-ve vazhdojnë të bien në të gjithë rajonin.¹³ Megjithëse OSHC-të në Mal të Zi janë entuziaste për ndryshimin e qeverisë, ato janë gjithashtu realiste se ka pak gjasa që të përmirësohet ndjeshëm situata për shoqërinë civile, ndërsa puna dhe aktiviteti i tyre shpesh duket të jetë e shkëputur dhe e izoluar nga qeveria dhe institucionet e saj.

Kornizat ligjore dhe financiare për të krijuar dhe themeluar një OJQ në vendet e Ballkanit Perëndimor duket se nuk paraqesin ndonjë problem.¹⁴ Gjatë viteve të fundit, shumë vende kanë miratuar rregullore të reja që e bëjnë bazën e tyre ligjore të përputhet me standardet e nevojshme për pranimin në BE. Sidoqoftë,

disa reforma të sugjeruara nga komuniteti ndërkombëtar, si miratimi i paketës së re ligjore kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit në Shqipëri,¹⁵ duket se janë (keq)përdorur për të rritur kontrollin e shtetit mbi shoqërinë civile.

Në Ballkanin Perëndimor, shumë ligje që duhet të krijojnë hapësira për OSHC-të janë zbatuar në mënyrë të mangët. Po kështu, pandemia COVID-19 ka krijuar sfida dhe probleme shtesë, që kufizojnë akoma më tej hapësirat e manovrimit për këto organizata. Pengesat burokratike dhe pengesat financiare e bëjnë të vështirë funksionimin dhe zhvillimin e një OJQ-je. Për shembull, në Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë, ku regjistrimi i një OJQ-je dhe çdo ndryshim administrativ bëhet në gjykatë, është dyfishuar koha e kërkuar për përbushjen e këtyre procedurave, që nga fillimi i krizës COVID-19, duke bllokuar praktikisht krijimin dhe regjistrimin e organizatave të reja.¹⁶ Në Serbi, kërkesa burokratike, si detyrimi për të paraqitur dokumente identiteti të të gjithë themeluesve të një OSHC-je për të ndryshuar numrin e llogarisë së saj bankare (pavarësisht nga koha kur është krijuar organizata, ose kush e drejton atë për momentin) e vështirësojnë punën e përditshme.¹⁷

	Shqipëri	Bosnjë Hercegovinë	Kosovë	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbi
OSHC të regjistruara ¹⁸	>11 000	>25 300	>9 400	>5 700	>16 900	>34 300
OSHC që punojnë mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin	49	36	24	27	35	34

FIGURA 3 Tablo e përgjithshme e organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor gjatë periudhës 2019–2020.

Ashtu si tregohet në Figurën 3, një numër i madh i OSHC-ve janë regjistruar në secilin vend. Sidoqoftë, shumë prej tyre mbyllen brenda një kohe të shkurtër, por nuk reregjistrohen.¹⁹ Në fakt, një shqyrtim më i hollësishëm i këtyre shifrave tregoi se një numër i konsiderueshëm i tyre janë në të vërtetë joaktive, pasi nuk kanë raportuar asnjë aktivitet ose angazhim me komunitetin përgjatë viteve të fundit. Për shembull, vetëm 10 përqind e të gjitha OSHC-ve të regjistruara në Shqipëri përmenden edhe në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.²⁰ Kjo mospërputhje midis numrit të OSHC-ve të regjistruara dhe organizatave aktive duket se është rezultat i paqëndrueshmërisë financiare të OSHC-ve dhe angazhimeve të tjera profesionale të personelit të tyre. E gjitha kjo bën që shumë OSHC të ndërpresin

veprimtarinë e tyre brenda një kohe të shkurtër. Figura 3 tregon gjithashtu se sa pak organizata në Ballkanin perëndimor përqendrohen në forcimin e rezistencës së komunitetit ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. OSHC-të që punojnë kundër krimit dhe korrupsionit përfshijnë qendra rinore dhe organizata me bazë rinore, OJQ që punojnë me gra ose pakica, dhe grupe të tjera të pambrojtura (p.sh. ish-të burgosur, apo përdorues drogash), gazetarë investigativë apo institute kërkimore.²¹ Është shumë e vështirë që të kuptosh dhe gjykojsh punën dhe përjasjen e këtyre organizatave, pasi ka një gamë shumë të gjerë situatash, veprimtarish dhe rezultatesh, që reflektojnë edhe natyrën e larmishme të krimit të organizuar në komunitete të ndryshme.

OSHC-të forcojnë rezistencën qytetare përmes një sërë aktiviteteve, duke filluar nga aktivitetet parandaluese në qendra rinore, deri tek mbështetja e grupeve në nevojë, formulimi i politikave dhe studime kërkimore. Shumica e organizatave mund të zhvillojnë një numër të larmishëm aktiviteteve e objektivash, dhe forcimi i rezistencës së komunitetit kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është një prej tyre. Për shkak të dobësisë ose mungesës së kontrolleve dhe ekuilibrave të brendshëm në disa struktura shtetërore në Ballkanin perëndimor, një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve marrin përsipër të kryejnë një rol mbikëqyrës mbi institucionet publike (p.sh. monitorimi i procesit të prokurimeve publike), një detyrë që zakonisht duhet të kryhet nga organe të pavarura publike. Siç shihet edhe në Figurën 4, shumica e këtyre organizatave i kanë zyrat qendrore në kryeqytete ose qendra kryesore urbane; megjithëse këto qytete mund të mos jenë zona problematike të krimit të organizuar.

Shumica dërrmuese e organizatave dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të intervistuar për këtë raport përmendën qëndrueshmërinë financiare si sfidën kryesore në punën e tyre. Ndonëse OSHC-të në të gjithë rajonin marrin fonde nga institucione publike, private dhe ndërkombëtare të angazhuara në këto procese, komuniteti ndërkombëtar (duke përfshirë ambasada, agjenci zhvillimi, dhe organizata ndërkombëtare) vazhdon të jetë donatori më i rëndësishëm.²² Për shembull, në Shqipëri BE dha 51 përqind të buxhetit të përgjithshëm të OSHC-ve gjatë vitit 2019.²³

Puna e shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit perëndimor varet shumë nga donatorët. Përfaqësuesit e shoqërisë civile thonë se shumica e granteve janë afatshkurtra, përqendrohen në qytetet më të mëdha dhe se ka pak mbështetje për aktivitete kundër krimit të organizuar²⁴. Kjo i lë OSHC-ve pak hapësira për të diversifikuar aktivitetet e tyre, ose për t'u specializuar në çështje që mendojnë se janë të rëndësishme për komunitetin.²⁵ Po kështu, kjo i bën OSHC-të që të reagojnë në varësi të situatës dhe të mos jenë proaktive, çka do të thotë që është e vështirë të tërheqësh ekspertë, ose të ndërtojnë një bazë të shëndoshë ekspertize mbi tema të veçanta, pasi stafit zakonisht pret të punojë në një projekt afatshkurtër, dhe më pas të kalojë në një temë tjetër për projektin e radhës. Mbështetja afatshkurtër me fonde gjithashtu vendos në pozitë të vështirë organizatat në komunitete më të vogla.²⁶ Ato mund të marrin fonde nga një donator i jashtëm për vetëm një projekt mbi krimin e organizuar ose korrupsionin, por kjo lë pasojë negative në marrëdhëniet dhe financimet e ardhshme me partnerët e qeverisë lokale. Një tjetër mangësi dhe burim shqetësimi për përfaqësues të shoqërisë civile është edhe përqendrimi mbi përparësitë e donatorëve, dhe jo nevojat reale të

komunitetit, si dhe vëmendja e tepruar që i kushtohet trajnimeve dhe marrjes së eksperiencës nga vende të tjera, në vend që t'i kushtohet rëndësi problemeve të vërteta lokale. Ashtu si vërejt një person i anketuar në Mitrovicë: "Ne nuk kemi nevojë për leksione, na duhen përvoja pozitive – vetëm në këtë mënyrë njerëzit e përvetësojnë 'mësimin'."²⁷ Shpeshherë rezultati i mbështetjes nga jashtë janë projekte afatshkurtra, që orientohen nga donatorët, dhe jo punë sistematike që mund të sjellë rezultate strategjike afatgjata.

Shumë organizatave iu mungon eksperiencia dhe ekspertiza për të shkruar propozime për projekte, për të biseduar me donatorë ose për të kërkuar ndihmë.²⁸ Sidoqoftë, këto organizata e njohin më mirë terrenin dhe janë një nga faktorët më të interesuar për përmirësimin e stabilitetit dhe integritetit në komunitetet e tyre. Një aktivist nga Shtipi në Maqedoninë e Veriut shpjegoi: "OSHC-të ekzistojnë për qytetarët dhe jo për donatorët. Ne mund të mos dimë të shkruajmë projekte që duken bukur në gjuhën që preferojnë donatorët, por ne jemi ata që punojmë në terren dhe jemi në kontakt direkt me shtresat në nevojë, për t'i ndihmuar që të zgjidhin problemet kryesorë që i shqetësojnë."²⁹ Një shembull i varësisë nga donatorët është parë në Serbi, ku shumë organizata u mbyllën pas vitit 2000 ndërsa donatorët ndërkombëtarë filluan të tërhiqeshin. Sidoqoftë, nga viti 2015 bashkësia ndërkombëtare e kuptoi që procesi i demokratizimit nuk po shkonte ashtu si duhej dhe filloi të investojë sërish tek OSHC-të. Vajti dëm shumë kohë dhe shumë eksperiencë, si dhe janë shkatërruar rrjetet e shoqërisë civile të ngritura asokohe: procesi i rindërtimit ka filluar, por shumë aktivistë lokalë që ishin angazhuar 20 vjet më parë me shoqërinë civile, tashmë janë përqendruar në tema të tjera.³⁰

Grantet afatshkurtra dhe varësia nga donatorët gjithashtu ofrojnë pak hapësira për të zhvilluar aftësitë themelore të stafit. Shumica e punonjësve merren në punë për nevojat specifike të projektit, madje disa të intervistuar u ankuan se donatorët nuk financojnë fare për paga, por presin që të punohet mbi bazën e honorareve.³¹ Disa nga përfaqësuesit e OSHC-ve thanë se ishin të detyruar të punonin në disa vende pune njëkohësisht për të kompensuar të ardhurat e ulëta ose sporadike nga këto projekte.³² Kjo mund të dekurajojë shumë të rinj nga angazhimi në sektorin e OSHC-ve, ndonëse mund të jenë të motivuar për punë dhe me lidhje të mira me komunitetin.³³ Kjo situatë shpesh i shtyn ekspertët drejt qyteteve më të mëdha, të kërkojnë punë në sektorin publik, ose në organizata qeveritare që ofrojnë më shumë stabilitet. Për më tepër, u vu re se ka pak hapësira për zhvillim profesional, kështu që edhe kur pagat janë të larta (si për shembull, në Kosovë³⁴), sektori i shoqërisë civile nuk konsiderohet si zgjedhje e mirë për karrierë.

Kush punon për OSHC?

Informacionet dhe të dhënat zyrtare shpesh janë të vjetruara dhe nuk japin informacion të saktë mbi stafin e organizatave të shoqërisë civile. Po kështu, shumë OSHC në rajon angazhojnë një numër të madh vullnetarësh, të cilët nuk janë regjistruar. Edhe të dhënat zyrtare mbi përbërjen gjinore të sektorit OSHC nuk janë të plota. Sidoqoftë, duke patur parasysh raportin gjinor të të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në dialogun kombëtar të rezistencës, mendohet se raporti i grave me burrat në sektorin OSHC në Ballkanin perëndimor është afërsisht 55 me 45. Nga ana tjetër, të dhëna dhe informacione informale sugjerojnë se gazetarët investigativë janë më shumë meshkuj sesa femra. Një studim i kryer nga fondacioni Friedrich-Ebert-Stiftung në Bosnjë Hercegovinë në 2015 mbledhi të dhëna mbi moshën e stafit të këtyre organizatave, dhe doli në përfundimin se ka një shpërndarje të barabartë midis të gjitha grupmoshave. Niveli mesatar i arsimit të stafit ashtu dhe vullnetarëve duket se është në rritje.³⁵

*Financimi
ndërkombëtar për
OSHC-të mund
të kthehet në një
problem, pasi
organizata mund të
konsiderohet si vegël
e të huajve, por nga
ana tjetër mbështetja
e partnerëve të huaj
ndihmon në forcimin
e shoqërisë civile.*

Ashtu si u përmend edhe më lart, OSHC-të në të gjithë rajonin marrin fonde kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë. Kjo mund të kthehet në një problem, pasi organizata mund të konsiderohet si vegël e të huajve, sikur bashkëpunon me 'agjentë të huaj', por nga ana tjetër mbështetja e partnerëve të huaj mund të ndihmojë në forcimin e shoqërisë civile, sidomos kur organizata ka mbështetjen e një partneri të jashtëm nga një shtet me të cilin vendi dëshiron të ketë marrëdhënie të mira. Në fakt, shumica e të intervistuarve thanë se bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë i lejon që të kenë më shumë liri veprimi, dhe janë më të lirë që të shprehin pikëpamjet e tyre në krahasim me varësinë nga financimet e qeverive të vendeve të tyre.³⁶ Disa përfaqësues të tjerë të OSHC-ve gjithashtu thanë se nuk aplikojnë fare për fonde qeveritare sepse nuk donin që të perceptoheshin nga publiku si të lidhur me institucionet shtetërore. Vihet re se ka pak bashkëpunim midis sektorit privat dhe OJQ-ve; pasi shumë organizata e shohin me dyshim origjinën e parave të sektorit privat dhe shpesh preferojnë të mos përzihen me ta.³⁷

Shpërndarja e fondeve të qeverisë është shpesh e paqartë dhe varet nga situata e momentit. Për shembull, në fillim të vitit 2020, qeveria lokale e kantonit të Sarajevës anuloi shpërndarjen e fondeve qeveritare për OSHC-të në minutën e fundit, për shkak të pandemisë COVID-19.³⁸

Pavarësisht nga paqartësia dhe pasiguria e mbështetjes financiare për OJQ-të, sasia e fondeve publike për shoqërinë civile është rritur këto vitet e fundit. Për shembull, në Kosovë financimi u rrit me 15 përqind për periudhën nga 2015 deri në 2017³⁹. Një fenomen i ngjashëm është vënë re edhe në Serbi, ku qeveria ka shpërndarë zyrtarisht më shumë fonde për sektorin e shoqërisë civile.⁴⁰ Nga ana tjetër, kjo prirje duhet të analizohet në kontekstin e rajonit: fondet shpesh akordohen për organizata pranë partisë në pushtet, ndërsa iniciativat e pavarura nga OJQ të komuniteteve nuk kanë shumë mundësi që të marrin mbështetje, pasi njoftimet për tender nuk publikohen, fondet mund të mbështesin projekte me afat të shkurtër, ose mund të vendosen kushte të tilla që përjashtojnë shumicën e OSHC-ve që në fillim të procesit. Nëpër të gjithë rajonin, OSHC që kanë lidhje të forta me pushtetin lokal, apo që janë themeluar nga zyrtarë të bashkive apo komunave, kanë marrë fonde për të kufizuar përhapjen e COVID-19.⁴¹

Çfarë janë OJQMQ-të?

Në Ballkanin perëndimor, OSHC-të shpesh konsiderohen si mbrojtëse të demokracisë, në opozitë me qeverinë, dhe të angazhuara fuqimisht në monitorimin e punës së institucioneve publike. Në ato vende ku opozita është e dobët, e përfshirë në krim të organizuar ose korrupsion, apo bojkoton parlamentin, ose ku qeveria shihet si e korruptuar ose bashkëpunëtore e grupeve kriminale, OSHC-të nganjëherë perceptohen më shumë si organizma anti-qeveritare dhe jo si organizata jo-qeveritare. Kjo i vë OSHC-të në pozitë të vështirë - dhe nganjëherë të rrezikshme - dhe mund të çënojë rëndë rolin e tyre si organizma apolitike.

Kjo ka çuar në ngritjen e një shoqërie civile paralele. Të ashtuquajturat OJQMQ janë organizata joqeveritare të krijuara nga qeveria ose aleatët e saj për të mbështetur interesat e tyre politike. Në këtë mënyrë, njerëz besnikë të pushtetarëve shpërblehen me fonde, ndërkohë që krijohet ideja në arenën ndërkombëtare sikur është arritur një nivel i mirë bashkëpunimi midis OSHC-ve dhe institucioneve shtetërore. Po kështu, krijohet përshtypja sikur partia në pushtet gëzon mbështetjen e OSHC-ve,⁴² ndërkohë që në realitet fondet publike përdoren për t'u dhënë shpërblime grupeve të caktuara.

Raportohet se në disa vende të Ballkanit perëndimor, një pjesë e madhe e fondeve qeveritare të destinuara për shoqërinë civile iu akordohen OJQMQ-ve. Ky nuk është thjesht shpërdorim i fondeve publike, por kemi të bëjmë gjithashtu me diskreditimin e OSHC-ve në përgjithësi, pasi krijohet përshtypja në publik se OJQ-të janë thjesht peng i partive politike ose grupeve të interesit. Përfaqësues të OSHC-ve që u intervistuan për këtë raport shprehën shqetësim në lidhje me shtimin e influencës së OJQMQ-ve në rajonin e WB6. Nga ana tjetër, aktivistë të OJQ-ve nuk bien dakord mbi mënyrën se si të luftohet ky fenomen, dhe hezitojnë që t'i sfidojnë hapur këto organizata, pasi kanë frikë do se të shihen sikur "thjesht po luftojnë për para."⁴³

Ekziston një farë bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe strukturave të qeverisjes vendore dhe qendrore në të gjitha vendet e WB6, dhe shumica e OSHC-ve e konsiderojnë bashkëpunimin me institucionet shtetërore si të nevojshme për të çuar përpara iniciativat e tyre. Sidoqoftë, ekziston një mungesë e theksuar besimi nga të dy palët. Disa OSHC e konsiderojnë qeverinë si problemin kryesor të shoqërisë, ndërsa OSHC-të shihen nga disa grupe dhe elementë të caktuar si tradhtarë të qeverisë dhe shoqërisë.⁴⁴ Kjo nuk i lejon OSHC-të që të përmbushin rolin e tyre si ura lidhëse midis publikut dhe qeverisë.

Si rezultat, dialogu midis OSHC-ve dhe qeverisë shpesh ka nevojë për ndërmjetësimin e organizmave apo donatorëve ndërkombëtarë që 'kërkojnë dhe insistojnë në bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore'.⁴⁵ Sidoqoftë, shumë nga këto takime bëhen thjesht sa për sy e faqe, sa për të krijuar idenë (kryesisht tek partnerët ndërkombëtarë) se qeveria po bashkëpunon me shoqërinë civile;⁴⁶ por rrallë arrihen rezultate pozitive në këtë drejtim.

Shumë OSHC thanë se ndihen si në grackë nga marrëdhënia e dyzuar me qeverinë e tyre, si nga ana financiare ashtu dhe morale: nga njëra anë funksionojnë si opozitë ndaj qeverisë dhe janë mbrojtës të interesit publik, por nga ana tjetër e pranojnë se është e nevojshme që të bashkëpunojnë me qeverinë për të

realizuar ndryshime pozitive dhe arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Në nivele më të ulëta, një problem tjetër është mungesa e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe shoqërisë civile, pasi shumë vendimmarrës janë indiferentë në këtë drejtim, madje janë kundër bashkëpunimit me OSHC-të. Në disa raste, të dy palët kanë opinione kaq të kundërta nga njëri-tjetri, saqë e konsiderojnë krahun tjetër si 'armik,' dhe kjo është për të ardhur keq, pasi lufta kundër krimit të organizuar duhet të jetë një qëllim i përbashkët. Një marrëdhënie e tillë e vështirëson shumë punën e organizatave më të vogla, sidomos kur ato varen nga grante që lëshohen nga zyrtarë të korruptuar, ose nga struktura pushteti që presin besnikëri apo favore në këmbim të fondeve.⁴⁷ Të intervistuarit vunë në dukje se është më e lehtë të krijosh marrëdhënie dhe të bashkëpunosh me punonjës të niveleve më të ulëta të institucioneve shtetërore, sesa me zyrtarë të niveleve të larta që janë të përfshirë në politikë.⁴⁸ Po kështu, u vu re se OJQ-të që ofrojnë shërbime për komunitetin kanë marrëdhënie më të mira me qeverinë, se sa OSHC-të që kryejnë rolin e vëzhguesit të qeverisë. Sipas raportimeve doli se qendrat rinore kishin marrëdhëniet më të mira me institucione të ndryshme publike. Nga ana tjetër, është vënë re se në momentin kur rritet presioni i publikut ndaj politikave shtetërore, qeveritë prirën të përmirësojnë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me OSHC-të.⁴⁹



Gazetarët në Ballkanin perëndimor punojnë në një atmosferë gjithnjë e më të rrezikshme. Këtu lart, protestë për lirin nga burgu të gazetarit investigativ Tomislav Kezarovski në Shkup. © Robert Atanasovski/AFP nga Getty Images

Liria e shprehjes në media

Gazetarët investigativë dhe organizatat e pavarura mediatike janë pjesë thelbësore e shoqërisë civile dhe luajnë një rol kryesor në denoncimin e krimit të organizuar dhe ndërgjegjësimin e publikut. Sidoqoftë, raportimi objektiv është i vështirë, pasi mediat shpesh janë të lidhura me partitë politike, ndërsa gazetarët ndonjëherë edhe vetëcensurohen si pasojë e rreziqeve që i kanosen sigurisë vetjake dhe familjeve të tyre. “Në një vend ku gazetarët vriten, është e vështirë të flasësh për lirinë e medias,” tha një gazetar nga Mali i Zi.⁵⁰ Një gazetar nga Banja Luka, Bosnjë Hercegovinë, hezitoi që të takonte ekipin e GI-TOC, pasi e kërcënonin çdo ditë.⁵¹

Ndonëse ka pasur vetëm pak raste kur OSHC-të janë kërcënuar drejtpërdrejt nga krimi i organizuar,⁵² kemi të bëjmë me një situatë shumë serioze për një numër të madh gazetarësh. Për shembull, në nëntor 2020, autorë të panjohur dëmtuan hyrjen e shtëpisë së Dinko Gruhonjiç, kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës, duke shkruar me bojë parulla dhe slogane të urrejtjes dhe intolerancës etnike.⁵³ Në një tjetër incident, në vitin 2020, u vu në shënjestër Ana Laliç, gazetare e portalit të lajmeve Nova.rs (gjithashtu në Vojvodinë), pasi u ndalua përkohësisht nga policia për raportimin mbi kushtet në një spital në Novi Sad gjatë fazës fillestare të pandemisë COVID-19.⁵⁴

Qeveritë në të gjithë rajonin po mundohen të kufizojnë lirinë e shprehjes dhe medias. Ka një sërë shembuj në këtë drejtim, siç është edhe paketa ligjore anti-shpifje në Shqipëri, e cila, nëse miratohet nga parlamenti, do

të kontrollojë mediat në internet.⁵⁵ Në Serbi, qeveria ka forcuar kontrollin mbi shpërndarjen e informacionit që nga fillimi i pandemisë COVID-19⁵⁶ dhe gazetarët janë bërë shënjestër e sulmeve verbale nga zyrtarë dhe media pro-qeveritare.⁵⁷ Më shumë se 120 sulme ndaj gazetarëve janë regjistruar në pesë nga gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor që nga fillimi i vitit 2020.⁵⁸ Në Maqedoninë e Veriut, qeveria publikoi një listë të mediave në internet duke përzgjedhur se cilat media do të merrnin leje për të punuar gjatë orëve të ndalim-qarkullimit gjatë krizës së COVID-19, dhe cilave do t'u lejohej hyrja në konferencat për shtyp.⁵⁹ Në Bosnjë Hercegovinë, prokuroria njoftoi se kishte hapur një hetim mbi motivet e gazetarëve që botonin informacione negative në lidhje me punën e tyre.⁶⁰ Po kështu, qeveritë mundohen të kufizojnë edhe aksesin e gazetarëve në informacion, duke i deklaruar disa të dhëna si sekrete shtetërore.

Pavarësisht nga këto probleme, një numër i vogël mediash private nga rajoni vazhdojnë të raportojnë mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ka edhe disa organizata mediatike që nuk merren vetëm me gazetari investigativ, por edhe mbështesin dhe trajnojnë gazetarë të rinj. Këtu mund të merren si shembuj Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ⁶¹ dhe Projekti i Raportimit mbi Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (OCCRP).⁶² KRIK, një nga anëtarët e rrjetit OCCRP me qendër në Beograd, është një nga OSHC-të e pakta në rajon që përqendrohet tërësisht mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin.



Ndonëse mungesa e bashkëpunimit midis OSHC-ve pengon përpjekjet e tyre të përbashkëta, kriza e COVID-19 ka rritur bashkëpunimin midis nismave të ndryshme. Këtu lart, qendra rinore Pomozimo Djeci në Bosnjë Hercegovinë. © PomozimoDjeci

Për fat të keq, ka patur pak bashkëpunim midis OSHC-ve, si dhe ndërmjet OJQ-ve, medias dhe akademisë. Për shembull, shumë pak OSHC angazhohen të trajtojnë çështje dhe probleme që zbulohen nga gazetarë investigativë, apo të çojnë një çështje në gjykatë pas denoncimeve në media.⁶³ Nga ana tjetër, megjithëse e njohin mirë situatën në terren dhe komunitetin, OSHC-të zakonisht nuk ftohen të bashkëpunojnë apo të japin opinionin e tyre gjatë punës kërkimore në terren nga universitetet, dhe rastet e bashkëpunimit midis akademisë dhe OJQ-ve janë të rralla.

Vihet re se ka mungesë solidariteti edhe midis vetë OSHC-ve, dhe madje ka konkurrencë të ashpër për sigurimin e burimeve financiare, ndërkohë që ka edhe një hendek të thellë midis OSHC-ve nga zonat kryesore urbane dhe atyre që punojnë në qytete më të vogla. Edhe kur arrihet bashkëpunimi, ai shpesh shërben për qëllime të tjera: përfaqësuesit e OSHC-ve nga Serbia shpjeguan se zakonisht nuk preferojnë të punojnë me organizata në komunitete, por ndonjëherë “e bëjnë këtë për të qenë më tërheqës tek donatorët, dhe për të arritur rezultate më të mira në aplikimet për grante”.⁶⁴

Kohët e fundit donatorët i kanë dhënë fonde organizatave ndërkombëtare (përmes degëve të tyre lokale) për të administruar projekte që më parë mbulohehin nga OSHC-të e rajonit. Po kështu, donatorët ndërkombëtarë prirën që të mbështesin OSHC më të mëdha dhe me më shumë eksperiencë. Këto organizata janë në gjendje që të tërheqin më shumë vëmendje dhe njerëz me përvojë, gjë që i vendos ato në një pozitë të favorshme për të

marrë akoma më shumë fonde në të ardhmen. Kjo krijon një situatë ku ndihmohet që të arrihet “sukses nga i suksesshmi”, gjë që thellon pabarazinë në këtë sektor. Për më tepër, donatorët kërkojnë nga organizata që mbahen me fonde vjetore që të formojnë rrjete bashkëpunimi, dhe madje të bëhen edhe mini-donatorë të OSHC-ve lokale, më të vogla. Ndonëse është bërë e mundur që të mbijetojnë shumë organizata të vogla, ka sjellë gjithashtu edhe zgjerimin e hendekut midis organizatave të vogla dhe të mëdha, pasi nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie partneriteti, por ngjason më shumë me një marrëdhënie donator - përfitues. Nga ana tjetër, kjo situatë i ka detyruar organizatat e mëdha që të shtojnë numrin e punonjësve të administratës.⁶⁵

Pavarësisht nga këto probleme, në kohë krizash bashkëpunimi dhe solidariteti nuk mungon. “Në thelb, ne (shoqëria civile) funksionojmë më mirë kur jemi nën presion. Atëherë e kuptoj se sa njohuri dhe aftësi ekzistojnë në sektorin e shoqërisë civile. Është për të ardhur keq që nuk ka më shumë sinergji, ndershmëri dhe lidhje më të shëndoshë mes nesh,” tha një përfaqësues OSHC-je nga Mali i Zi.⁶⁶ Edhe përfaqësues të OSHC-ve nga Maqedonia e Veriut raportuan mbi marrëdhënie të mira pune midis OSHC-ve, dhe me institucionet qeveritare gjatë krizës së emigrantëve në vitin 2015.⁶⁷

Duket se kohët e fundit shoqëria civile dhe media po bashkëpunojnë më ngushtë me njëra-tjetrën, ndonëse po tkurret hapësira për shoqërinë civile në të gjithë rajonin, dhe po shtohen sulmet ndaj zërave kritikë dhe OSHC-ve.



▲
Kontrabanda
e mallrave të
paligjshme vazhdon
të jetë një problem
shqetësues në rajon.
© Elvis Barukcic/AFP
nga Getty Images

ANALIZË E ZHVILLIMEVE DHE PRIRJEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR NGA KËNDVËSHTRIMI I SHOQËRISË CIVILE

Para se të shqyrtojmë më nga afër rolin e shoqërisë civile në forcimin e rezistencës ndaj krimit të organizuar, duhet të analizohen veçoritë e krimit të organizuar në zona të ndryshme, dhe perceptimet e komuniteteve mbi këtë problem. Në këtë mënyrë, mund të arrijmë të kuptojmë më mirë se si mund të forcohet qëndresa qytetare ndaj krimit.

Ndonëse krimi i organizuar është një problem serioz në Ballkanin perëndimor, intervistat e kryera gjatë këtij studimi treguan se OSHC-të që punojnë në rajon kanë njohuri të kufizuara përsa i përket analizimit dhe përbaljes me këtë fenomen. Është për tu habitur, por disa aktivistë që merreshin me çështje që lidheshin me ekonominë e paligjshme nuk e kuptonin termin 'krim i organizuar', ose ngulnin këmbë se ai nuk ishte i pranishëm në komunitetet e tyre. Vetëm gjatë diskutimeve të mëtejshme, dhe me ndihmën e shembujve konkretë, ata arritën të kuptonin përhapjen dhe ndikimin e këtij problemi në shoqëri. Po kështu, bashkëbisedues të tjerë treguan se e njihnin mirë problemin në krahinën e tyre, por nuk arrinin të kuptonin mirë se si kjo lidhet me një ekosistem më të gjerë krimi në vend ose rajon, dhe mënyrat se si mund të luftohet ky problem.

Shumë OSHC të intervistuar për këtë projekt punojnë në të ashtuquajturat zona problematike të krimit të organizuar - në pozicione gjeografike strategjike për trafikim, si në kryqëzime nyjesh transporti, pranë kufirit, në kryeqytete, ose në zona të varfra me probleme të theksuara social-ekonomike që i bëjnë tërheqëse për grupet kriminale.⁶⁸ Informacionet e dhëna nga disa përfaqësues të OSHC-ve tregojnë gjeografinë e krimit në rajon. Për shembull, të intervistuarit në Sarandë thanë se një nga shqetësimet e

tyre kryesore ishte trafiku i qenieve njerëzore; një tjetër nga Vlora, përmendi kultivimin e paligjshëm të kanabisit; ndërsa përfaqësuesit e OSHC-ve nga Struga në Maqedoninë e Veriut, zona e Karacevës në Kosovë, dhe Sapna në Bosnjë Hercegovinë, përmendën kontrabandën në rajonet kufitare.

Zonat problematike janë zakonisht vende ku droga kalon, paketohet, dhe madje edhe prodhohet. Trafikimi i paligjshëm i drogës (kanabis, kokainë, heroinë dhe drogë sintetike) mbetet një nga aktivitetet kriminale më fitimprurëse në rajon, dhe tërheq shumë persona që nuk shohin ndonjë të ardhme nga punësimi i rregullt në ekonominë formale.

Nga ana tjetër, duket se Ballkani Perëndimor nuk është më 'vetëm një rajon tranzit', pasi konsumi i drogës në rajon po rritet. Ashtu si shpjegoi një përfaqësues OSHC-je nga Struga: "Deri disa vite më parë, ky rajon (në jugperëndim të vendit) ka qenë vetëm një zonë tranziti, por sot drogat janë të përhapura kudo, dhe gjenden lehtësisht nga të gjithë. Varësia nga droga, veçanërisht në mes të të rinjve, është rritur, por autoritetet preferojnë të bëjnë një sy qorr."⁶⁹ Grupi i studiuesve të GI-TOC dëgjoi komente të ngjashme në qytete dhe zona të tjera në rajon nga Novi Sad në Serbi, në Mostar në Bosnjë Hercegovinë, dhe në Shqipëri, në Kamëz.

Puna kërkimore mbi krimin e organizuar në Ballkanin perëndimor zakonisht përqendrohet në nivelin makroekonomik të tregjeve dhe grupeve kriminale, dhe mbi ekonominë politike të krimit të organizuar. Sidoqoftë, përfaqësuesit e OSHC-ve të intervistuar për këtë raport kishin më shumë shqetësime në nivel lokal, domethënë krimi mjedisor, zhvatja dhe dhënia e huave me interesa tepër të larta, shfrytëzimi i krahut të punës, huliganizmi, pastrimi i parave në industrinë e ndërtimit, dhe mbi të gjitha, korrupsioni. Ata ishin veçanërisht të shqetësuar për ndikimin e këtyre aktiviteteve kriminale mbi sigurinë e komunitetit dhe punën e tyre. Një i intervistuar vuri në dukje se "përzierja me këto çështje, në një vend ku nuk ka sistem për të mbrojtur qytetarët, mund të jetë me rrezik për jetën."⁷⁰ Persona nga komunitete më të vogla ngritën shqetësimin për shtimin e akteve të hapura të dhunës, vrasjet në rrugë dhe rrëmbimet. Ata folën për krijimin e një klimë frike; shumë vrasje mbeten të pazgjidhura, madje "ndonjëherë edhe vetë policia ka frikë të përmendë emrat e kriminelëve të vvarë në përplasje midis bandash."⁷¹

Informacionet në kapitujt që vijojnë analizojnë dhe hedhin dritë mbi aktivitete të krimit të organizuar që shkaktojnë më shumë shqetësime për OSHC-të që morën pjesë në diskutime, dhe që u intervistuan për këtë raport.

Krimi mjedisor

Krimi mjedisor, që përfshin prerjen e paligjshme të pyjeve, gjuetinë pa leje, dhe korrupsionin në shfrytëzimin e burimeve natyrore, duket se paraqet një shqetësim të veçantë për shumë komunitete. OSHC-të ambientaliste në Shqipëri kanë raportuar se janë shtuar ndjeshëm krimet kundër botës shtazore nga gjuetia pa leje gjatë viteve të fundit, pasi kjo praktikë po bëhet më fitimprurëse (p.sh. për shkak të çmimeve të larta për rrëqebullin e Ballkanit).⁷² Miratimi i një moratoriumi për ndalimin e gjuetisë në Shqipëri në vitin 2014 nuk e ka zgjidhur problemin, por përkundrazi ka bërë që të reduktohet ndjeshëm kontrolli i policisë që monitoronte më parë situatën në terren.⁷³ Në Maqedoninë e Veriut, shoqëria civile raporton për aktivitete të paligjshme në prerjen e pyjeve, që nga grupe të vogla kriminale që shkaktojnë dëme relativisht të vogla, deri tek organizata të mëdha kriminale që bashkëpunojnë ngushtë me policinë dhe politikanët lokalë.⁷⁴ Një përfaqësues i një OSHC-je shpjegoi se të ardhurat nga prerjet e paligjshme të pyjeve përdoren pjesërisht për të financuar fushata zgjedhore.⁷⁵

Shumë OSHC zhvillojnë aktivitetin e tyre në zona problematike të krimit të organizuar.



Trafikimi i qenieve njerëzore është veçanërisht i pranishëm në zonat kufitare, veçanërisht për prostitucion. Këtu shihet një manifestim në Shkup ku bëhet thirrje për t'i dhënë fund dhunës ndaj punonjësve të seksit.

© Robert Atanasovski/AFP nga Getty Images

Shfrytëzimi i krahut të punës, duke përfshirë edhe prostitucionin

Shfrytëzimi i krahut të lirë të punës duket se përdoret gjerësisht në shumë fabrika të mëdha në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri (veçanërisht në industrinë e veshjeve), ku punëtorët detyrohen që t'i kthejnë mbrapsht firmës ku punojnë gjysmën e pagës së deklaruar zyrtarisht, duke i lënë atyre më pak se 150 euro në muaj.⁷⁶ Po në këtë rajon, një sërë organizatash ofrojnë mbështetje për gra dhe vajza që kanë rënë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore (veçanërisht për prostitucion). Ky lloj krimi është

veçanërisht i përhapur në zonat kufitare. OJQ-të e rajonit gjithashtu raportojnë se fëmijët që detyrohen të lypin shfrytëzohen seksualisht nëse nuk mbledhin mjaft para.⁷⁷ Lajmet që vijnë nga Mali i Zi sugjerojnë se, që nga fillimi i pandemisë COVID-19, është rritur numri i femrave që detyrohen të prostitutojnë.⁷⁸ Në maj të vitit 2020, 16 persona u arrestuan në Bijeljina, Bosnjë Hercegovinë, për organizim prostitucioni të femrave boshnjake (dhe nga vendet fqinje), si dhe për trafik droge dhe armësh zjarri.⁷⁹

Zhvatja dhe huatë e paligjshme

Shumë biznese dhe organizata në të gjithë rajonin vazhdojnë të përballen me zhvatje dhe kreditë e paligjshme me interesa tepër të larta, probleme që u shfaqën pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe rënies së komunizmit në Shqipëri. Në Shkodër, bizneset e vogla detyrohen që të paguajnë afërsisht 3,000 lekë (25 euro) në muaj për 'mbrojtje'.⁸⁰ Në Maqedoninë e Veriut, të intervistuarit raportuan se 'xhandarët e zonës' zhvatin para nga "çdo biznes që nuk ka mbrojtje politike"⁸¹, ndërsa në Bosnjë Hercegovinë një bandë kriminale me nam shumë të keq ushtron shantazh

dhe gjërit bizneset në Mostar dhe Trebinjë.⁸² Sipas një studimi të kohëve të fundit në Nish, Serbi, doli se afërsisht gjashtë për qind e të anketuarve kanë patur përvoja personale me marrjen e huave me interesa tepër të larta nga elementë kriminalë, ndërsa 41 për qind e të anketuarve thanë se kishin dëgjuar për këtë problem nga miq apo të afërm.⁸³ Shumë nga ata që folën për përvojat e tyre personale, gjithashtu treguan se kishin përjetuar dhunë fizike ose ishin kërcënuar. Këta persona nuk bënë denoncime pranë autoriteteve, por iu drejtuan për ndihmë OSHC-ve të zonës.⁸⁴



Huliganizmi dhe bandat e të rinjve në rajon përbëjnë rrezik për sigurinë publike, pasi anëtarët e grupeve huligane nganjëherë janë të lidhur me krimin e organizuar. © Klub Masa

Huliganizmi dhe bandat e të rinjve

Bandat e lagjeve që bashkëpunojnë me krimin e organizuar kontrollojnë zona të ndryshme të qyteteve në rajonin e Ballkanit perëndimor. Për shembull, në Laus, një qytezë afër Banja Lukës në Bosnjë Hercegovinë, banorët vendas duhet të paguajnë 'taksë' për të kaluar në lagjen ngjitur.⁸⁵ Këto banda kriminale shpesh janë të lidhura me grupe huliganësh futbollit, politikanë dhe biznesmenë të dyshimtë. Gjatë periudhës janar – shtator 2020, në Mostar u regjistruan më shumë se 10 incidente me huliganë, që shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale ndërsa disa qytetarë u plagosën gjatë këtyre trazirave.⁸⁶ Banorët e Mostarit thonë se kur ka ndeshje futbollit midis klubeve të qytetit (nga lagje të ndryshme të Mostarit), është më mirë të qëndrojnë në shtëpi, që të mos bien viktimë të përleshjeve midis grupeve rivale.⁸⁷ Këto incidente shpesh shoqërohen me slogane nacionaliste dhe propagandë të krahut të djathtë, rrallë ndodh që këta persona të ndiqen penalisht.

Shumë grupe i shtojnë radhët e tyre duke rekrutuar djem të rinj, veçanërisht ata që janë larguar nga zonat rurale për të ndjekur shkollat e mesme në qytet. Grupet e huliganëve ndonjëherë janë të lidhur me krimin e organizuar, dhe rekrutët e rinj fillimisht përdoren për të shitur kanabis, si xhepista dhe për grabitje të vogla, dhe më vonë përfshihen në zhvatje dhe shantazhe, dhënie huash me interesa tepër të larta dhe shpërndarje droge.⁸⁸

Në Serbi, shumica e personave të dënuar për sjellje të dhunshme në aktivitete sportive ose tubime publike kanë qenë dënuar më parë për sulme të dhunshme, vjedhje, vrasje, dhunë ndaj kafshëve, ose prodhim të paligjshëm, posedim apo trafik droge e armësh.⁸⁹ Po kështu, ka të dhëna se një numër i madh të rinjsh po përpiqen të krijojnë grupe të reja kriminale për të kontrolluar trafikun e drogës në zona të caktuara, ndërsa shumë të rinj duan të bëhen pjesëtarë të grupeve huligane në Beograd, ose grupeve të tjera të tifozëve 'ultras'.⁹⁰

Pastrimi i parave dhe mafia urbane

Investimet në sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtëshme ka shumë kohë që thithin pasuritë e paligjshme në vendet e Ballkanit perëndimor, pasi ky sektor ka rëndësi të madhe ekonomike për vendet e rajonit, ndërsa kontrolli shtetëror është i dobët.⁹¹ Pallate shumëkatëshe ndërtohen në parcela toke ku për dekada me radhë shtriheshin lagje me shtëpi të vogla banimi.

Këto pallate shpesh ndërtohen nga persona që punojnë në të zezë, pa kontrata pune, ose që paguhen pak.⁹² Ky fenomen vazhdon të shqetësojë seriozisht komunitete të tëra, jo vetëm në lidhje me shkeljet në këtë sektor, por edhe se bumi në ndërtim rrallë shoqërohet me uljen e çmimit të banesave apo në forcimin e ekonomisë formale.

Në fakt, zhvillimi ekonomik në vendet e Ballkanit perëndimor ka ngecur në vend gjatë këtyre viteve të fundit, me nivele të larta papunësie, veçanërisht tek të rinjtë. Pagat mesatare vazhdojnë të mbeten të ulëta, por çmimet e pasurive të patundshme po rriten.⁹³ Në fund të vitit 2019, çmimi mesatar i një apartamenti banimi në Tiranë, arriti në gati 1,000 euro për metër katror.⁹⁴ Edhe çmimet e pronave në

Ohër, në Maqedoninë e Veriut, janë rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtyre viteve, dhe madje kohët e fundit kanë tejkaluar edhe çmimet në Shkup.⁹⁵ Po kështu, një studim i kryer kohët e fundit në Serbi tregoi se më shumë se 84 për qind e të gjitha pasurive të paluajtëshme u shitën me para në dorë gjatë periudhës janar – maj 2020.⁹⁶

Korrupsioni

Ekosistemi i krimit lulëzon aty ku ekziston një lidhje e ngushtë midis biznesit, krimit dhe qeverisë. Shumica e përfaqësuesve të shoqërisë civile që u intervistuan gjatë këtij studimi thanë se problemet kryesore në vendet e tyre ishin korrupsioni, mosfunksionimi i institucioneve, dhe apatia e administratës publike në të gjitha nivelet. Kjo atmosferë pandëshkueshmërie shpesh lidhet me aktivitete të tjera të paligjshme, si pastrimi i parave në ndërtim, ose keqpërdorimi i burimeve natyrore. Sipas Fondacionit Shoqëria e Hapur, vendet e Ballkanit perëndimor shpenzojnë mesatarisht 7 miliardë euro në vit për prokurime publike, por dy miliardë euro (afërsisht 30 për qind e shumës totale) zhduken për shkak të korrupsionit.⁹⁷ Raportimet mediatike tregojnë se partitë politike, forcat e policisë dhe prokuroritë shpesh ndjekin interesat e tyre në përballjen me grupet kriminale, dhe sillen në mënyrë selektive sipas nevojave së momentit.

Disa OSHC në rajon angazhohen në monitorimin e proceseve të prokurimit publik të pushtetit lokal. Persona të intervistuar nga zona të ndryshme në Maqedoninë e Veriut thanë se nuk është ndonjë sekret i madh se për të marrë leje ndërtimi duhet t'i dhurosh ndonjë zyrtari të lartë të bashkisë nga një apartament për çdo kompleks banimi.⁹⁸ Në Kosovë, janë shënuar disa raste të ndërtimeve pa leje, duke përfshirë këtu komunat e Pejës dhe Istogut; madje disa prej tyre po hetohen nga autoritetet për lidhje të mundshme midis bizneseve dhe zyrtarëve publikë.⁹⁹ Organizata Transparency Serbia, e cila monitoron nga afër prokurimin e produkteve dhe pajisjeve mjekësore në kuadër të krizës COVID-19, ka ngritur shqetësime në lidhje me fshehjen e kontratave publike në Serbi.¹⁰⁰ Që nga fillimi i pandemisë COVID-19 dhe vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Bosnjë Hercegovinë,

janë akorduar ose janë arritur marrëveshje për më shumë se 410 kontrata me fonde shtetërore pa njoftime të regullta publike.¹⁰¹

Ekziston ideja sikur korrupsioni është pjesë përbërëse e sistemit. 'Thjesht kështu funksionojnë gjërat,' tha një përfaqësues i një OSHC-je nga Bosnjë Hercegovina.¹⁰² 'Korrupsioni duket i ngulitur aq thellë në sistem, sa që edhe nëse dikush do t'i kundërvihet korrupsionit të nivelit të lartë ose krimit të organizuar, ata që janë në krye gjithmonë do të mbrohen nga sistemi,'¹⁰³ tha një person tjetër nga Kosova.

Edhe OSHC-të nganjëherë përfshihen në praktika korruptive. Për shembull, e ashtuquajtura Shoqata Ndërkombëtare, një OJQ për ndihma humanitare në Maqedoninë e Veriut, kohët e fundit ka qenë nën hetim për mashtrim.¹⁰⁴ Hetime për evazion fiskal po zhvillohen edhe ndaj disa drejtorëve të OSHC-ve në vende të ndryshme të rajonit, si për shembull në Mal të Zi¹⁰⁵, dhe Bosnjë Hercegovinë.¹⁰⁶ Rastet e përfshirjes së këtyre organizatave në korrupsion dëmtojnë integritetin e të gjithë sektorit të shoqërisë civile, dhe ulin nivelin e besimit të publikut ndaj OSHC-ve.¹⁰⁷

Është e pamundur që të analizohet me hollësi në këtë raport ndikimi i plotë i ekosistemit të krimit, por shembujt e përmendur këtu tregojnë se pasojat ndihen në të gjitha nivelet. Zhvillimi i dobët ekonomik, pastrimi i parave, korrupsioni, mbizotërimi i ekonomisë informale, madje edhe pandemia COVID-19, kanë rritur pabarazinë sociale, duke detyruar shumë njerëz që të emigrojnë ose të përfshihen në aktivitete kriminale. "Një nga problemet më të mëdha me shoqërinë tonë është se është shumë e lehtë që bëhesh pjesë e krimit dhe / ose korrupsionit. E shikon tortën aty përpara dhe kërkon të marrësh një copë për vete."¹⁰⁸



MBËSHTETJE PËR FAKTORËT QË BËJNË TË MUNDUR QËNDRESËN SHOQËRORE

Dëmi afatgjatë dhe strukturor që shkaktohet nga krimi i organizuar dhe qeverisja kriminale në vendet e Ballkanit perëndimor mund të zbutet vetëm nëpërmjet një angazhimi shumëpalësh dhe të shumëanshëm, duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Aktivistët e shoqërisë civile mund të luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm kur ndërhyrjet nga ana e shtetit nuk janë të efektshme, i japin dorë krimit apo e përkeqësojnë problemin. Në situata të tilla problematike, OSHC-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e rezistencës në komunitete, dhe duhet të qëndrojnë të bashkuar në përballje me krimin.¹⁰⁹

Në mënyrë që të arrihet forcimi i qëndresës qytetare në komunitete duhet të arrijmë të kuptojmë përse forma të ndryshme të krimit të organizuar janë bërë pjesë e kulturës lokale, dhe si ndikojnë në jetën e komunitetit. Është gjithashtu e rëndësishme që të identifikohen problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen komunitetet, për të nxjerrë në pah ato faktorë që mund të ndihmojnë popullatën të përballen me këto çështje, dhe për të mbështetur faktorët dhe strukturat kryesore që mund të japin kontribut në këtë drejtim.¹¹⁰ Qëndresa komunitare mund të jetë një proces transformues i zhvillimit të kapaciteteve të individëve dhe komuniteteve për të parandaluar, reaguar dhe rikuperuar në mënyrë të efektshme nga goditjet dhe problemet që lindin nga qeverisja kriminale.¹¹¹

Reagime të forta qytetare kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit regjistrohen rrallë në vendet e Ballkanit perëndimor. Ndonëse shumica e aktivistëve të shoqërisë civile në rajon i mbrojnë me pasion komunitetet e tyre, dhe janë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit, shumë prej tyre nuk kanë burime, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për t'iu kundërvënë krimit të organizuar në mënyrë koherente, sidomos duke patur parasysh se duhet të punojnë brenda sistemeve të kriminalizuara.



Është shumë e rëndësishme të kuptojmë se si krimi i organizuar është bërë pjesë e kulturës lokale dhe si ndikon në jetën e komunitetit.

© Qendra Rinore Vlorë

OSHC-të shpesh ndihen të vetmuara në përballje me kërcënimet që vijnë nga krimi i organizuar. Organizatat e komuniteteve, veçanërisht në qytete dhe fshatra më të vegjël, ku ka pak elementë dhe faktorë që nxisin rezistencën, ndihen të ekspozuar dhe shpesh hezitojnë që të ngrenë zërin e tyre. Shumë prej tyre nuk janë pjesë e rrjeteve kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare dhe janë të ekspozuara ndaj presioneve të qeverive lokale ose grupeve kriminale. Niveli i rrezikut është i lartë, ndërsa vëmendja nga donatorët është e ulët. Përveç kësaj, shumë prej tyre ndihen të pafuqishme, përballë një sfide që perceptohet si tepër e madhe. Në intervista, dëgjuam shprehje të tilla si 'është si të luftosh me mullinj të erës'¹¹², ose qëndrime fataliste si 'asgjë nuk mund të bëhet për të ndryshuar situatën, ky është sistemi'.¹¹³ Një tjetër i anketuar tha: 'Nëse do të ndryshosh diçka, mos humb kohë me shoqërinë civile, futju politikës'.¹¹⁴

Është e vështirë, madje edhe e rrezikshme, që OSHC-të lokale t'i dalin ballë për ballë krimit të organizuar. Në radhë të parë, kjo është punë e policisë. Nga ana tjetër,

duke qenë se krimi i organizuar lulëzon atje ku ka probleme dhe vështirësi, OSHC-të duhet të punojnë që të reduktojnë avantazhin e krimit në këto zona problematike duke forcuar qëndresën komunitare. Kjo përfshin punën me grupe rinore, angazhimin në çështje të përdorimit të drogës, ri-integrimit pas burgut, përpjekjet anti-korrupsion, kundërvënien ndaj krimit mjedisor, punën me grupe të marginalizuara, dhe reagimin kundër dhunës ndaj grave. Këto çështje jo vetëm që janë të rëndësishme në vetvete, por mund të ndihmojnë edhe në reduktimin e ekspozimit ndaj krimit të organizuar.

Krijimi i një baze mbështetjeje në komunitet, forcimi i qëndresës qytetare, dhe ndryshimi i situatës nuk realizohet dot brenda një kohe të shkurtër. Për shembull, OSHC-ja e parë në Bijeljina, Bosnjë Hercegovinë, u themelua gati 20 vite më parë, me synimin për të punuar me numrin në rritje të romëve që vendoseshin në atë zonë. Sot ka 13 organizata aktive, me një bazë vullnetare që sa vjen e zgjerohet, që punojnë për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemet e komunitetit, dhe puna e tyre ka filluar të japë rezultate.¹¹⁵

Pushteti i mediave sociale

Mediat sociale janë bërë një mjet i domosdoshëm për të kontaktuar të rinjtë dhe për t'i angazhuar në procese sociale. Një pjesë e të rinjve në Ballkanin perëndimor i tërheq jeta luksoze e njerëzve të famshëm që e shohin nga postimet në mediat sociale. Për shembull, një këngëtar repi, që i ka thurur këngë trafikimit të marihuanës dhe fantazon për një jetë krimi, ka 1.6 milion ndjekës në Instagram. Në Bosnjë Hercegovinë, profilet e disa kriminelëve të njohur ose njerëzve të afërt me grupet kriminale kanë nga më shumë se 500,000 ndjekës.¹¹⁶ 'Të jesh kriminel po bëhet e modës,' tha një aktivist nga Prijedor, në Bosnjë Hercegovinë.¹¹⁷

OSHC-të në të gjithë rajonin e kanë kuptuar se sa të fuqishme janë mediat sociale. Shumë prej tyre përdorin Facebook si mjetin kryesor të komunikimit në komunitet, madje edhe Instagram po përdoret gjithnjë e më shumë, ndonëse numri i ndjekësve është i vogël. Po të mbledhësh numrat e ndjekësve në mediat sociale për të gjitha OSHC-ve që punojnë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Serbi, del se kanë vetëm rreth 500,000 ndjekës – mbi një milion ndjekës më pak se një këngëtar repi. Në Mal të Zi, OSHC-të kanë më



Të rinjtë joshen nga bota e krimit përmes mediave sociale. © Snoëyins/Dreamstime.com

pak se 100,000 ndjekës. Në Banja Luka, Bosnjë Hercegovinë, një gazetar që ka marrëdhënie të mira me komunitetin komunikon me 55,000 ndjekës nëpërmjet mediave sociale.¹¹⁸

Çdo komunitet ka metoda dhe përqasje të ndryshme për t'iu kundërvënë llojeve të ndryshme të krimit të organizuar dhe korrupsionit në mes tyre. Por në të gjitha rastet ndërhyrjet e suksesshme janë ato që i përshtaten veçorive të secilit komunitet, dhe që përfshijnë komunitetin në të gjitha fazat e procesit. Ato e vënë theksin jo vetëm mbi fenomene negative që luftohen nga komuniteti (si krimi i organizuar, korrupsioni, dhe klientelizmi politik) por i bëjnë jehonë edhe objektivave që kërkon të arrijë komuniteti (duke përfshirë çështje të tilla si integriteti, transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë). Mund të organizohen aktivitete të ndryshme, si ngjarje kulturore, klube debati, dhe diskutime të hapura me një numër sa më të madh të palëve të interesuara, si dhe projekte ambientaliste që përqendrohen posaçërisht mbi zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe ambientit që e rrethon. Ka disa faktorë dhe elementë që kanë kontribuar në suksesin e iniciativave në të gjitha vendet e WB6:

- **Organizatrat rinore:** Qendrat rinore dhe personeli i tyre në përgjithësi respektohen nga shoqëria, dhe shpesh gëzojnë edhe mbështetjen e strukturave të qeverisjes vendore. Këto organizata mund të ndikojnë pozitivisht në jetën e të rinjve, pasi ato ofrojnë një hapësirë më të shëndetshme për të kaluar kohën e lirë dhe për t'i mbajtur fëmijët larg nga jeta e rrugës. Kjo nuk i lejon bandat që të rekrutojnë me lehtësi anëtarë të rinj, dhe ofron një këndvështrim alternativ për ata që janë përfshirë në krimin e organizuar, ose që janë rritur në një mjedis kriminal.¹¹⁹ Për më tepër, edhe sporti dhe aktivitetet zbavitëse e rritin vetëbesimin tek të rinjtë, dhe i vë në kontakt me modele pozitive.

Shumë nga të intervistuarit theksuan rëndësinë e punës me të rinjtë për të ndryshuar këndvështrimet negative mbi botën që u janë ngulitur nga e kaluara, dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi krimin e organizuar dhe marrëdhëniet ndëretnike. Organizata të tjera përqendrohen në punën me përdorues të mitur të drogës dhe ish të dënuar, grupe që rrezikojnë të rekrutohen nga banda kriminale.¹²⁰ Në disa vende organizohen edhe javë rinore, ku promovohen vlerat e komunitetit përmes diskutimeve dhe debateve të hapura, aktiviteteve në natyrë dhe në ndihmë të komunitetit (për shembull, pastrimi i hapësirave publike).¹²¹

- **Ndërmarrjet shoqërore:** Koncepti i ndërmarrjeve shoqërore është një nocion relativisht i ri për Ballkanin perëndimor. Zakonisht në të gërshetohen dy elemente: aktiviteti i biznesit, si kafene, hotel apo ndonjë biznes tjetër që gjeneron të ardhura, dhe një element shoqëror që përqendrohet në mirëqenien e komunitetit. Ndërmarrje të tilla krijojnë lidhje të rëndësishme midis sektorit privat dhe shoqërisë civile, afrojnë staf të ri dhe vullnetarë me përvojë pune, si dhe krijojnë hapësira për t'i bërë këto ndërmarrje më të qëndrueshme nga ana financiare me kalimin e kohës. Problemi është se kuadri ligjor në disa vende mund të komplikojë ngritjen dhe funksionimin e ndërmarrjeve shoqërore, pasi këto sipërmarrje duhet të paguajnë më shumë taksa në krahasim me bizneset e tjera.¹²² Në Serbi, një ndërmarrje shoqërore në Novi Sad merr fonde nga një kompani që merret me transport mallrash,¹²³ ndërsa në Shqipëri disa OSHC sigurojnë fonde nga kafene, kopshte për fëmijë, ose të ardhura nga shërbime të tjera. Në këto raste, angazhimi i komunitetit në aktivitete sociale është i lidhur ngushtë me mbështetjen komunitare të këtyre ndërmarrjeve. Projekti C.A.U.S.E në Shqipëri meriton një vëmendje të veçantë: aktivitetet e tij zhvillohen në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar, duke demonstruar kështu avantazhet e ekonomisë formale dhe bizneseve të ligjshme, ndërkohë që i bëhet rezistencë krimit të organizuar.¹²⁴
- **Ofruesit e shërbimeve:** Shumë OSHC në rajon ofrojnë shërbime të rëndësishme, si për viktimat e krimit të organizuar (nëpërmjet linjave telefonike të këshillimit, strehëzave për njerëz në nevojë, etj.), ashtu dhe për ish-keqbërës (si për shembull, ndihmë pas vuajtjes së dënimit). Riintegrimi në shoqëri, duke përfshirë edhe ata që kanë vuajtur dënime me burg jashtë vendit, vazhdon të jetë një problem serioz pasi është e vështirë të ndryshosh mendësinë e njerëzve të joshur nga pasurimi i shpejtë me mënyra të paligjshme, ka paragjykim dhe stigmatizim nga ana e shoqërisë, ndërsa nuk është e lehtë as të gjendet punësim i kënaqshëm në ekonominë formale.

Qëndresa komunitare zhvillon aftësitë e komuniteteve për të parandaluar, reaguar dhe rikuperuar nga problemet që lindin nga qeverisja kriminale.

Rrjetet e OSHC-ve ndihmojnë në forcimin e solidaritetit dhe përmirësimin e bazës së njohurive, dhe në këtë mënyrë rritet edhe ndikimi i shoqërisë civile.

Qendrat këshillimore për përdoruesit e drogës mund të ndihmojnë në lehtësimin apo ndreqjen e probleme të shkatuara nga droga, dhe ofrojnë shërbime të rëndësishme për komunitetin. Për shembull, në Serbi dhe Mal të Zi, është ngritur një rrjet qendrash që ofrojnë ndihmë dhe një gamë të gjerë shërbimesh për përdoruesit e drogës, duke filluar që nga shpërndarja e shiringave sterile, deri tek mbështetja psikologjike dhe vizita mjekësore falas. Ky rrjet organizon edhe programe arsimore dhe fushata ndërgjegjësimi.¹²⁵

- **Organet e mediave lokale dhe institutet kërkimore:** Organet e mediave lokale luajnë një rol shumë të rëndësishëm në raport me qëndrimin e një komuniteti kundrejt krimit të organizuar dhe korrupsionit, pasi i ofrojnë publikut informacion mbi këto probleme. OSHC-të që merren me krimin e organizuar zakonisht e marrin informacionin nga burime të hapura informimi, por qeveria mundohet ta pengojë këtë proces duke sulmuar mediat. Shumë organizata mediatike jo vetëm që rrisin ndërgjegjësimin e publikut ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, por ofrojnë edhe platforma bashkëbisedimi e debati konstruktiv në komunitete, si dhe trajnojnë gazetarë të rinj në metoda të reja investigative, duke përfshirë edhe hetime financiare apo ndjekjen e procedurave gjyqësore.¹²⁶

Përfaqësues të OSHC-ve të konsultuar për këtë raport dhanë opinionet dhe idetë e tyre mbi forcimin e qëndresës ndaj krimit në të gjithë Ballkanin perëndimor, dhe aktivitetet që mund të zhvillohen gjatë punës së tyre me komunitete të ndryshme. Si hap i parë, ata thanë se është e rëndësishme që të krijohet një bazë të dhënash kombëtare (apo edhe rajonale) për të identifikuar donatorët ekzistues dhe potencialë, si dhe organizata të tjera vendase që punojnë për çështje të ngjashme. Ata gjithashtu theksuan rëndësinë e formimit të rrjeteve më të forta dhe më të qëndrueshme midis organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe forcimin e partneriteteve strategjike me sektorë të tjerë.


Aktivistët e kontaktuar për këtë studim vunë në dukje se ka akoma shumë punë për të bërë për të bashkëpunuar më ngushtë me sektorin privat në vendet e Ballkanit perëndimor. Bizneset private shpesh dëmtohen nga krimi dhe korrupsioni (përmes zhvatjes, pastrimit të parave, etj), por nuk ka ndonjë traditë bashkëpunimi midis sektorit privat dhe OSHC-ve. Ky bashkëpunim jo vetëm që do të ndihmonte në diversifikimin e të ardhurave të OSHC-ve, por do të bënte të mundur shkëmbimin e eksperiencës dhe bashkëpunimin midis të dyja palëve për t'u përballur me kërcënime të përbashkëta.

Krijimi i rrjeteve të shoqërisë civile nuk shërben vetëm për të arritur një konsensus mbi çështje të caktuara, por më i rëndësishëm është krijimi i një platforme për shkëmbimin e ideve dhe njohurive në lidhje me objektiva të përbashkëta.¹²⁷ Krijimi i një rrjeti të organizatave që kanë objektiva dhe mendësi të ngjashme mund të krijojë edhe një atmosferë solidariteti dhe sigurie. Nga ana tjetër, nëse shoqëria civile dëshiron që të rritet ndikimi i saj në terren duhet të shtohen përpjekjet dhe puna në këtë drejtim. Për momentin, vetëm pak rrjete OSHC merren me problemin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, madje edhe ato pak organizata varen nga fonde për projekte. Si rezultat, kur mbaron një projekt, edhe rrjeti shkrihet. Rrjetet e OSHC-ve, në nivel lokal apo më gjerë, ndihmojnë në krijimin e solidaritetit dhe përmirësimin e bazës së njohurive, dhe kështu rritin ndikimin e shoqërisë civile në publik. Në këtë kontekst, ia vlen të përmenden Koalicioni Preugovor (që fokusohet mbi kapitujt 23 dhe 24 të anëtarësimit në BE)¹²⁸ dhe Koalicioni për Mbikqyrjen e Financave Publike (i cili përqendrohet tek prokurimet)¹²⁹ në Serbi. Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit midis sektorëve të ndryshëm të shoqërisë civile (OJQ, media, academia, institucionet fetare dhe sindikatat) duhet të inkurajohet si në nivel kombëtar, ashtu dhe në nivel rajonal. Në mënyrë që të arrihen rezultate sa më pozitive në të ardhmen, duhet që aktivistët lokalë të rezistencës të krijojnë kontakte edhe me partnerë ndërkombëtarë.

Ndërtimi i një rrjeti global me aktivistë të rezistencës

Në vitin 2020, GI-TOC krijoi aplikacionin VIVA, një platformë e sigurt komunikimi në media sociale që lidh me njëra-tjetrën iniciativat e rezistencës komunitare nga e gjithë bota. Ky është një aplikacion i bazuar në materiale video, ku aktivistë që punojnë me projekte në komunitete të ndryshme mund të postojnë materiale dhe informacione nga terreni, për të dokumentuar ndikimin e krimit të organizuar në komunitetet e prekura, dhe mbi të gjitha për të pasqyruar reagimin e komunitetit ndaj tij. Aplikacioni ndihmon në përmirësimin e aftësive dhe njohurive, përvetësimin e praktikave më të mira sociale nga aktivistët e rezistencës shoqërore, dhe bën të mundur koordinimin e aktivitetëve midis një sërë aktorësh.

Me qëllim që të krijojë lidhje midis OSHC-ve lokale dhe partnerëve jashtë rajonit, GI-TOC aktualisht po punon për zgjerimin e funksioneve të VIVA-s, për të bërë të mundur që përdoruesit e saj të lidhen me rrjete globale dhe politikëbërës, si dhe me rrjetin global të GI-TOC, që përfshin më shumë se 500 ekspertë që punojnë për hartimin e strategjive dhe kundërpërgjigjeve të reja dhe inovative ndaj krimit të organizuar.



Aplikacioni VIVA i krijuar nga GI-TOC synon të krijojë lidhje midis iniciativave të qëndresës komunitare anembanë botës.

Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit forcon gjithashtu edhe pozitën e shoqërisë civile në raport me qeverinë. Të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar ranë dakord se duhet të ketë bashkëpunim me pushtetin lokal dhe qeveritë kombëtare, dhe se OSHC-të duhet të përfshihen në të gjitha fazat e kundërvënies ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, që nga parandalimi, denoncimi dhe dënimi. Krijimi i marrëdhënieve më të ngushta të bashkëpunimit me autoritetet e zbatimit të ligjit u përmend gjithashtu si një element me rëndësi të veçantë. Sidoqoftë, të intervistuarit theksuan gjithashtu se partneritete të tilla duhet të vijnë natyrshëm dhe nuk duhet të imponohen nga faktorë të jashtëm (ndërkombëtarë).

Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit, rritja e numrit të aktivitetëve për shkëmbim njohurish midis OSHC-ve, forcimi i solidaritetit midis faktorëve strategjikë, dhe krijimi i një baze të gjerë mbështetjeje në komunitet janë elementë bazë për të mundur rezistencën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin perëndimor. Pjesëmarrësit në studim theksuan gjithashtu se ndryshimi i

kulturës së pandëshkueshmërisë është një hap me rëndësi thelbësore për t'i treguar komunitetit, dhe veçanërisht të rinjve, se përfshirja në krim ka pasoja serioze. Dënimet e buta për vepra kriminale jo vetëm që nuk shërbejnë si parandalues të përfshirjes në krime të tjera, por edhe i dekurajojnë aktivistët shoqërorë që të ngrihen në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Edhe roli i rëndësishëm që luan arsimiti tek të rinjtë u përmend shpesh gjatë diskutimeve. Në shumë shkolla në vende të Ballkanit perëndimor, kurrikulat nuk përfshijnë tema dhe diskutime mbi krimin e organizuar, korrupsionin, apo normat shoqërore. Është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë që në moshë të re se çfarë është krimi dhe pse është i dëmshëm për shoqërinë. Një nga pjesëmarrësit tha: "Ata mendojnë se shkaravitja e mureve të shkollës me grafitë është krim, por kujtojnë se mbjellja e kanabisit nuk është ndonjë problem."¹³⁰ Mësues, prindër dhe personalitete të komunitetit duhet të ndihmojnë të rinjtë që të rritin nivelin e vetëbesimit dhe respektit për veten, në mënyrë që të forcohet imuniteti i tyre ndaj veprimtarive të paligjshme.



▲
Është e nevojshme që të arrihet një koordinim më i mirë i punës midis organizatave të shoqërisë civile për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë në vendet e Ballkanit perëndimor. Këtu lart, protestues në Serbi.

© Milos Miskov/Anadolu Agency/Getty Images

KONKLUZIONE DHE HAPAT PËR TË ARDHMEN

Përvoja e GI-TOC në lidhje me angazhimin e faktorëve dhe figurave kryesore të komuniteteve në të gjithë botën ka treguar se individët dhe grupet e komunitetit janë në gjendje të përmirësojnë aftësitë e tyre individuale dhe kolektive për t'iu kundërpërgjigjur krimit të organizuar, dhe janë në gjendje ta marrin veten nga pasojat dhe problemet e lëna pas nga krimi. Ky raport tregon qartë se OSHC të guximshme dhe të përkushtuara në të gjithë Ballkanin perëndimor janë angazhuar në këtë proces, por ato kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe ndihmë që të forcojnë më tej qëndresën e komuniteteve.

Në shumë zona të rajonit vihet re një mungesë sistematike e koordinimit dhe solidaritetit midis OSHC-ve, dhe nuk ka instrumente për shpërndarjen dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të suksesshme. Të dhënat dhe informacionet mbi prirjet dhe zhvillimet lokale, dhe mbi çështjet kryesore të krimit të organizuar dhe korrupsionit janë të pamjaftueshme dhe shpesh të njëanshme. Përveç kësaj, shoqërisë civile ndonjëherë i mungon edhe ndërgjegjësimi rreth lidhjeve midis krimit të organizuar dhe çështjeve thelbësore si siguria publike dhe zhvillimi shoqëror. Këto probleme paraqesin një pengesë serioze për forcimin e rezistencës ndaj krimit të organizuar.

Pandemia COVID-19 dhe ndërhyrjet e qeverive për t'u përballur me krizën, si ndalimet e tubimeve publike dhe vendosja e ndalim qarkullimit, penguan në mënyrë të konsiderueshme punën e shoqërisë civile për angazhimin e komunitetit, në një kohë kur kjo ishte shumë e nevojshme, veçanërisht për të ndihmuar dhe mbështetur shtresat në nevojë. Shumë përfaqësues të OSHC-ve, duke përfshirë edhe disa që morën pjesë në këtë studim, u infektuan me koronavirus dhe u detyruan të pezullonin aktivitetet e tyre. Disa të tjerë kaluan në përdorimin e platformave në internet, por nuk patën bashkëpunim të mjaftueshëm nga baza e tyre në komunitet. Disa

